



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.3.1-2012-08

RAPORT I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË GJAKOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtinë, Qershor 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Gjakovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri mbështetur nga Florim Maliqi (Udhëheqës i ekipit), Ardita Jetullahu dhe Mexhit Ferati.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare.....	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	11
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	12
5 Sistemi i auditimit të brendshëm.....	27
6 Konkluzioni i përgjithshëm	28
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP	30
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	32

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-të) për vitin 2012 për Komunën e Gjakovës. Me këtë rast, dëshiroj të falënderoj Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Auditimi i PVF për vitin 2012 ishte ndërmarrë në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Vlerësimin nëse PVF paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale;
- Menaxhimin Financiar dhe Auditimin e Brendshëm, duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit; dhe
- Procedurat e pajtueshmërisë.

Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij në formatin e përcaktuar në nën kapitullin 2.3- Opinioni i Auditimit. Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e ZAP. Raporti i AP-së përfshin një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e PVF.

Opinionin e AP është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Si Theksim i çështjes Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm. Regjistri i pasurive fikse nuk ka ndikim në ndonjëren prej 2 Pasqyrave Vjetore Financiare (Pranimet dhe Pagesat e Parasë së Gatshme dhe Krahasimin e Buxhetit dhe Shumat Aktuale), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. **(SNISA: 400 Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes).**

Konkluzioni i përgjithshëm

Niveli i punës së ndërmarrë nga ana e ZAP për të përfunduar auditimin e vitit 2012 është pasqyrim i drejtpërdrejtë i cilësisë së mjedisit të kontrollit të brendshëm. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Ne ishim në gjendje të kemi siguri në funksionimin efektiv të kontrolleve menaxheriale në një numër fushash të llogarive, por kemi identifikuar edhe dobësi në disa fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar. Dobësitë janë të shpjeguara më në detaje më poshtë.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim të mbështesin Komunën e Gjakovës në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe rritjen e aspekteve tjera të aktivitetit operacional. Ne kemi konsideruar përgjigjet ndaj rekomandimeve tona të bëra në vitin 2011. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se nevojiten veprime të mëtejme për të adresuar disa rekomandime të rëndësishme nga viti i kaluar.

Kemi diskutuar cilësinë e raportimit financiar të Komunës së Gjakovës dhe të gjeturat e tona të detajuara të auditimit në lidhje me Pasqyrat Vjetore Financiare, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Llogaridhënien e Menaxhmentit si dhe Auditimin e Brendshëm në pjesën kryesore të këtij raporti.

Rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e Komunës janë si në vijim:

Pasqyrat Vjetore Financiare

- Shpalosja e plotë e pasurive fikse në Pasqyrat Vjetore Financiare në pajtim me standardet dhe kërkesat ligjore në fuqi.

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

- Duhet të nxirret një plan detal i veprimit që të përcaktojë qartë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës, me fokus fillestar në ato të një rëndësie më të madhe;
- Një çasje e përmirësuar e kontrolleve duhet të zbatohet në identifikimin e bizneseve aktive në kuadër të Komunës para faturimit të ardhshëm, si dhe mekanizmat e inkasimit duhet të zhvillohen më tej;
- Duhet të bëhet një analizë e detajuar e të hyrave për vitin 2012 për të siguruar plotësinë e pranimeve dhe për të siguruar që një proces i fuqishëm është funksional për të përcaktuar rrjedhat e mundshme të të hyrave në vitet e ardhshme;
- Duhet të bëjë një shqyrtim në menaxhimin e projekteve, shërbimeve apo punëve, me fokus të veçantë në përmbushjen e afateve dhe kushteve tjera kontraktuese;

-
- Të gjitha zotimet duhet të monitorohen për të siguruar se zotimet nuk i tejkalojnë ndarjet buxhetore; dhe
 - Të diskutohet plani vjetor i auditimit të brendshëm, me synimin që fushëveprim parësor të jetë trajtimi i fushave me rrezik të lartë për biznesin e komunës, si dhe rekomandimet e dhëna të zbatohen nga të gjitha nivelet e menaxhimit.

Përgjigje nga menaxhmenti:

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe është zotuar se do ti adresojnë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e Komunës së Gjakovës të përgatis PVF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për Komunën e Gjakovës. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testeve të përgjithshme e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2011 mund të gjendet në Shtojcën II.

Ne kemi përfshirë gjetjet e rëndësishme dhe të tjera më pak të rëndësishme, që dalin nga auditimi ynë. Për plotësinë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të 9 mujorit aty ku ishte relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të rëndësishme - Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhmenti i lartë e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

Të tjera - Dobësitë e identifikuar në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe janë shtrirë vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në PVF. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga ZKA dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave vjetore financiare. Një numër i pikave në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithpërfshirës.

2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Konkluzioni i përgjithshëm

PVF ishin përgaditur në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” ku është përdorur formati standard i raportimit, përveç çështjes së shpalosjeve për pagesat nga palët e treta dhe regjistrimit të plotë të pasurive jofinanciare. Më gjërësisht, këto janë trajtuar në kapitullin vijues - Cilësia dhe saktësia e informatave.

Përshkrimi

PVF duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi vërejtur:

- Pajtueshmërinë me RrF Nr 07/2011;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- PVF janë pranuar vetëm në gjuhën shqipe; dhe
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike.

Rekomandim

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që me rastin e përgatitjes së PVF duhet merret parasysh edhe obligimi ligjor që PVF të përgatiten edhe në gjuhën serbe.

2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna ka arritur të përgatisë PVF sipas Rregullës Financiare nr. 07/2011 mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore, përveç vlerësimit të plotë të pasurive fikse. PVF përmbajnë të gjitha informatat e kërkuara në pasqyrat kryesore, përveç mungesës së shpalosjeve dhe shënimeve shpjeguese

Përshkrimi

Si rezultat i punës sonë audituese, janë bërë rregullime në draft PVF të paraqitura për auditim. Ne kemi dhënë edhe një numër sugjerimesh tjera për të përmirësuar shpalosjet e shënimeve dhe për të siguruar plotësinë e informacioneve shpjeguese të kërkuara si në vijim:

- Prezantimin dhe shpalosjen e pagesave nga palët e treta;
- Shpjegimet lidhur me ndryshimet e buxhetit final me atë fillestar; dhe
- Për marrjen e informatave nga kadastri për të gjitha pronat komunale si dhe regjistrimin e tyre.

Pas sugjerimeve tona, përveç vlerësimit të plotë të objekteve në pronësi të komunës, si dhe shpalosjes për pasuritë jofinanciare nën 1,000€, komuna ka bërë plotësimin e PVF për shpalosjen e pagesave nga palët e treta si dhe shënime shpjeguese për ndryshimin e buxhetit final me atë fillestar.

1. Çështja - Prezantimi i Pasqyrave Vjetore Financiare - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Te shënimi 30: Përmbledhja e pasurive jo-financiare kapitale me vlerë mbi 1,000€, ishte prezentuar në PVF prej 34,896,000€, derisa kjo shumë nuk mund të jetë e plotë për shkak të mos regjistrimit të disa objekteve të uzurpuara vite më parë nga personat e ndryshëm. Zyrtarët komunal kanë pohuar se mos regjistrimi i plotë i objekteve në pronësi të saj ka ardhur si rezultat i ngecjes së punës së komisionit i formuar disa vite më parë.

Rreziku Mos regjistrimi i plotë i pasurisë jo-financiare e cila është në kompetencë të komunës mund të shpie në keqkuptimin e pozitës financiare të komunës, me mundësinë e keqkuptimit të kërkesave buxhetore në të ardhmen.

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se plani sistematik i përpilimit të pasqyrave financiare inkorporon kërkesën për të përfshirë tërë vlerën e pasurive. Menaxhmenti ka nevojë të monitoroj zbatimin e kësaj kërkesë. Sygjerohet që në të ardhmen e afërt, komisioni i formuar të vazhdoj vlerësimin e plotë të të gjithë pasurisë fikse në pronësi të Komunës.

2.3 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si Theksim i çështjes Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm. Regjistri i pasurive fikse nuk ka ndikim në ndonjërin prej 2 Pasqyrave Vjetore Financiare (Pranimet dhe Pagesat e Parasë së Gatshme dhe Krahasimin e Buxhetit dhe Shumat Aktuale), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. **(SNISA: 400 Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes).**

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna nuk kishte përgaditur një Plan Veprimi për të adresuar rekomandimet e dhëna nga auditimi i vitit të kaluar.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2011 të Komunës kishte rezultuar në 10 rekomandime kryesore.

Ne kemi vërejtur se, tre (3) rekomandime ishin adresuar plotësisht; tre (3) janë adresuar pjesërisht, dhe katër (4) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

2. Çështja - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Komuna kishte adresuar vetëm pjesërisht rekomanimet tona. Rekomandimet lidhur me prokurimin, trajtimin e borxheve të mbetura dhe auditimin e brendshëm, nuk ishin marrë fare në konsiderim. Mangësitë në këto fusha kanë vazhduar të përsëriten.

Rreziku Dështimi i adresimit të rekomandimeve rrit rrezikun që dobësitë e kontroleve të brendshme në sistemet kyçe financiare të rezultojnë me përsëritjen e dobësive, në joefikasitet të vazhdueshëm organizativ dhe vlerë të dobët për para në praktikën e prokurimit dhe në performancën mbi të hyrat.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të siguroj që do të hartohet plani i veprimit ku në mënyrë të qartë do të përcaktoj afate kohore për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës, të identifikuar - me fokus fillestar në ato të një rëndësie të madhe.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Kjo mund, për shembull, të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrolleve operative të nivelit më të ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna ka arritur që buxhetin e vet ta shfrytëzoi deri në masë prej 98%. Kjo është një indikator se në kuptimin kuantitativ, komuna ka shfrytëzuar buxhetin në nivel maksimal, ndonëse dështime janë vërejtur në zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe pagesave.

Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrave të mbledhura. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në Euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi	2010 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	18,292,716	20,123,480	19,624,022	18,049,205	14,982,532
Granti i Qeverisë-Buxheti	15,509,428	16,459,429	16,448,318	15,649,501	12,659,854
Të bartura nga viti paraprak	-	498,109 ²	491,511	415,588	217,418
Të hyrat vetjake	2,783,288	2,783,289 ³	2,449,266	1,894,746	2,011,341
Donacionet Vendore	-	331,144	199,222	43,288	75,680
Donacionet e Jashtme	-	51,509	35,705	46,082	18,239

Sipas të dhënave nga tabela më lartë, shihet se buxheti final për vitin 2012 për komunën e Gjakovës ka qenë 20,123,480€. Shpenzimet totale për vitin 2012 ishin 19,624,022€ apo rreth 98% e buxhetit.

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 1,830,764€. Ndryshimi në mes buxhetit fillestar dhe final ka ndodhur për shkak se komunës i është ndarë një grant shtesë në shumë prej 950,002€, të hyrave vetjake nga viti i kaluar prej 498,109€, si dhe donacioneve të brendshme dhe të jashtme në shumë prej 382,653€.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në Euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi	2010 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	18,292,716	20,123,480	19,624,022	18,049,205	14,982,532
Pagat dhe Mëditjet	10,173,871	10,201,356	10,196,103	9,785,772	7,688,222
Mallrat dhe Shërbimet	1,497,938	1,735,414	1,708,009	1,373,884	1,260,334
Komunalitë	548,799	650,699	649,066	530,617	525,870
Subvencionet dhe Transferet	403,000	1,073,000	1,069,566	446,837	336,351
Investimet Kapitale	5,669,108	6,463,011	6,001,278	5,912,095	5,171,755

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak, të bartura në vitin aktual.

³ Të hyrat vetjake të planifikuara.

Ndonëse ekzekutimi i buxhetit në shkallën prej 98% tregon një performancë të lartë, në kuptimin e cilësisë dhe rregullsisë, shpenzimet e buxhetit janë shoqëruar me disa mangësi, madje edhe parregullsi. Procedurat e shpenzimeve, do t'i trajtojmë në kapitullin 4.5.

Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të mbledhura, kundrejt buxhetit (në Euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Të hyrat vetjake	2,783,288	2,783,289	2,778,027	2,382,421	2,394,701

Siq shihet nga tabela, gjatë vitit 2012 të hyrat kanë shënuar një rritje. Të hyrat e realizuara në vitin 2012 ishin më të larta për 395,606€ apo rreth 17%, krahasuar me vitin 2011.

Në bazë të rishikimit analitik është vërejtur se nga të hyrat vetjake (përfshirë edhe donacionet) janë shfrytëzuar për investime kapitale 2,193,401€ apo 79%, për mallra shërbime në shumë prej 419,835€ apo 15% nga shuma totale.

4.3 Kërkesat e raportimit

Konkluzioni i përgjithshëm

Sa i përket kërkesave të raportimit financiar që dalin nga legjislatura në fuqi, Komuna i ka përmbushur dhe ka respektuar afatet e kërkuara.

Përshkrim

Komuna e Gjakovës i ka përmbushur të gjitha obligimet për raportim të jashtëm. Obligimet e përmbushura janë paraqitur në vijim:

- Kërkesa Buxhetore për financimin e projekteve kapitale në Ministrinë e Financave;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Draft Plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë;
- Raportet mbi borxhet e dorëzuara në MF; dhe
- Raportin e vetëvlerësimit.

4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Konkluzion i përgjithshëm mbi të hyrat

Komuna e Gjakovës formalisht ka vendosur kontrole mbi të hyrat, por kontrollet si të tilla, nuk operojnë në nivelin e kënaqshëm. Ato kërkojnë përmirësime të mëtejshme, sidomos në sigurimin e të dhënave mbi lejet e ndërtimit, përsosjen e softuerit për regjistrimin e të gjitha ngarkesave dhe pagesave, me qëllim të raportimit të saktë të të hyrave. Të nxirren politika të qarta me mekanizmat e duhur se si të inkasohen borxhet e mbetura nga vitet paraprake, ato nga tatimi në pronë dhe borxhet tjera.

Përshkrimi

Komuna e Gjakovës gjatë vitit 2012 sipas regjistrave të Free Balance-it ka realizuar të hyra në shumë prej 2,778,027€ dhe pothuajse 100% kishte përmbushur planin e vitit 2012. Edhe pse të hyrat vetjake kanë shënuar një rritje në vitin 2012, këto të hyra kanë mundur të tejkalojnë planin sikur komuna të arrinte të mbledhte borxhe të vjetra nga tatimi në pronë, taksa në firmë dhe të hyra të tjera.

3. Çështja - Mangësitë e Softuerit - Prioriteti -tjetër

E gjetura Komuna e Gjakovës posedon softuer për regjistrimin e të gjitha të hyrave. Të dhënat manuale ekzistuese menaxhohen në mënyrë të dobët. Pothuajse në të gjitha rastet, të dhënat nga kontabiliteti përveç inkasimeve, nuk janë të regjistruara saldoto e bartura nga viti paraprak.

Rreziku Informacionet aktuale mbi të hyrat nuk janë të sakta ose të plota dhe nuk janë në dispozicion në kohën e duhur për ta mbështetur vendimmarrjen e menaxhmentit. Sistemet manuale ekzistuese për sistemimin e informatave mbi të ardhurat mund t'i nënshtrohen një manipulimi.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të sigurojë se një sistem i duhur i regjistrimit është vënë në funksion për të mbështetur inkasimin dhe regjistrimin e të hyrave. Nëse instalimi i një programi të veçant nuk është i mundur, sistemi manual (Excel) duhet të përmirësohet.

4. Çështja - Mungon evidenca mbi qiramarrësit e lokaleve - Prioriteti - i rëndësishëm

- E gjetura** Tek të hyrat nga shfrytëzimi pronës publike, përkatësisht lokaleve me qira, komuna e Gjakovës nuk mbanë regjistër kontabël për gjendjen e bartur nga viti i kaluar dhe ngarkesat e vitit vijues. Shuma e inkasuar deri në fund vitin 2012, ishte 15,264€ ndërsa shuma e planifikuar ishte 90,000€. Krahasuar me vitin 2011 kur të hyrat nga qiraja ishin inkasuar gjithsej 56,211€, flet për një menaxhim të dobët nga ky lloj i të hyrave. Sipas zyrtarit përgjegjës mungesa e një regjistri mbi ngarkesat nga qiraja është si rezultat i mos regjistrimit të plotë të lokaleve që janë në pronësi komunale.
- Rreziku** Një përmbledhje jo e plotë e ngarkesave dhe pagesave për të gjithë qiramarrësit e objekteve mund të rezultojë në nën pagim të qirasë.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të zbatoj një proces regjistrimi të të gjitha pronave dhe ngarkesave shoqëruese, dhe të përcjellë në baza mujore arkëtimin e qirave.

5. Çështja - Ndërtimet pa leje - Prioriteti - i rëndësishëm

- E gjetura** Departamenti për urbanizëm sikurse në vitin 2011, as gjatë vitit 2012 nuk kishte mbajtur një regjistër për ngarkesat e përfituesve të lejeve ndërtimore. Gjithashtu, ne kemi verifikuar aktvendimet për dy objekte të cilat ishin në ndërtim e sipër, nëse këto objekte janë legale. Për të dy këto objekte, urbanizmi nuk kishte dhënë leje ndërtimi, ndërsa objektet veç ishin ndërtuar. Sipas pohimeve të zyrtarëve ndërtimi i këtyre dy objekteve të ndërtimit të lartë ishte bërë për shkak të paaftësisë së inspektoriatit për të ndalur punimet nga investitori.
- Rreziku** Mungesa e një sistemi të fuqishëm për adresimin e projekteve të ndërtimit mund të rezultojë në humbje financiare/kostove për komunën, siç ka rezultuar edhe me dëmtimin e mjedisit dhe shëndetit, si dhe shqetësimet për sigurinë e qytetarëve..
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të rishikojë sistemet ekzistuese për të kontrolluar projektet e ndërtimit, të vlerësojë efektivitetin e tyre përfshirë edhe mbështetjen e dhënë ligjore dhe zbatimin e përmirësimeve të kërkuara. Inspektorati i ndërtimit duhet të aplikojë të gjitha kontrollet e duhura.

6. Çështja - Inkasim i dobët për taksë në ushtrimin e veprimtarisë - Prioriteti - i rëndësishëm

- E gjetura** Sipas regjistrit kontabël të komunës të hyrat e planifikuara për taksë në firmë për vitin 2012 është 233,600€ ndërsa ishin inkasuar gjithsej shuma prej 169,792€ apo 73%. Brenda territorit të Gjakovës operojnë 5,318 biznese. Sipas të dhënave të ofruara borxhet nga vitet paraprake për këtë lloj të hyrave janë 967,000€. Inspektoriati në kuadër të komunës nuk kishte arritur që me vizitat e tyre të ndikoj që këto biznese të bëhen pagues të rregullt. Nuk dihen se sa biznese janë aktive dhe jo aktive në kuadër të komunës.
- Rreziku** Politikat e inkasimit duket të jenë të dobëta për të siguruar maksimizimin e të hyrave, e po ashtu edhe kontrollet operative nuk janë efektive. Vonesat në mbledhjen e të hyrave, sjellin edhe dështimet në vendimmarrjen e menaxhmentit për financimin e projekteve nga ky burim.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të siguroj se Departamenti i të hyrave posedon një përditësim të vazhdueshëm të bazës së të dhënave të bizneseve aktive për të mbledhur borxhet e mbetura. Rezultatet duhet të monitorohen në vazhdimësi.

7. Çështja - Borxhe të pa inaktuara- Prioriteti - i rëndësishëm

- E gjetura** Drejtoria për tatim në pronë për vitin 2012 kishte faturuar shumën prej 975,536€. Nga shuma totale e faturuar gjithsej ishin inkasuar 968,817€ apo 99% nga plani. Ne kemi vërejtur se drejtoria për tatim në pronë ende nuk ka një mekanizëm adekuat për mënyrën se si të inkasojnë borxhet në shumë prej 3,425,750€, sidomos për ato kompani të cilat janë privatizuar.
- Rreziku** Planifikimi jo i bazuar në analiza të rrezikut, ka mundësi të rezultoj me një shkallë të pamjaftueshme të inkasimit, në akumulimin dhe prolongimin e borxheve nga viti në vit. Tatimi në pronë si burim i vetëm i tatimit, ka ndikime direkte në realizimin apo shmangien e objektivave buxhetore të komunës.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).

4.5 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm mbi shpenzimet

Komuna ka vendosur kontrolle formale mbi shpenzimet që nga inicimi i kërkesës deri te ekzekutimi i kontratës, por në nivelin operativ ato janë të dobëta për të siguruar rregullsinë e procesit.

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

Vlera e kontratave të nënshkuara përmes procedurave të prokurimit ishte 6,975,637€. Ne kemi testuar 15 mostra të kontratave në vlerë 2,583,771€ apo rreth 40% nga vlera e kontraktuar. Nga testimi i këtyre mostrave kemi gjetur këto parregullsi:

8. Çështja - Devijim nga procedurat e prokurimit dhe mungesë e zotimit të fondeve - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Te projekti "Renovimi i dyshemevë për dy shkolla fillore" në vlerë 16,940€, kemi vërejtur se prokurimi kishte shpallur dhe anuluar dy herë tenderin për shkak të mos paraqitjes së numrit minimal të ofertuesve të përgjegjshëm. Pas shpalljes së tretë të tenderit, kishte ofertuar vetëm një ofertues me të cilin edhe ishte lidhur kontratë. Ne nuk kemi gjetur ndonjë dokument me shkrim i cili do të dëshmonte se para lidhjes së kontratës me të vetmin ofertues është bërë njëfotimi i KRPP-së. Zotimi i mjeteve për këtë projekt ishte në vlerë 7,095€. Në anën tjetër në rishpalljen e parë, i njëjti ofertues kishte ofruar çmimin 12,705€.

Tek projekti "Ndërtimi i rrugës Rripaj - Jahoc" është lidhur kontratë më datën 11.04.2012 në shumë prej 148,435€, ndërsa shuma e zotuar ishte vetëm 19,000€. Raste të tjera të lidhjes së kontratave pa fonde të mjaftueshme janë identifikuar edhe tek projekti "Asfaltimi i rrugës në fshatin Mejë" ku ishte lidhur kontratë në shumë prej 93,619€, ndërsa ish-in zotuar vetëm 12,000€. Pastaj, në projektin "Asfaltimi i rrugëve në fshatin Brekoc" ishte lidhur kontratë në shumë prej 308,479€, derisa mjetet e zotuara ish-in në shumë prej 35,000€. Raste të tilla janë identifikuar edhe në projektet tjera.

Rreziku Prokurimi nuk ka respektuar rregullat e prokurimit për njoftimin e KRPP-së për lidhjen e kontratës me të njëjtin ofertues. Kjo nuk është në pajtim me LPP. Hyrja në detyrime pa fondet e buxhetuara mund ta sjellë komunën në vështirësi të papritura financiare dhe përballjen me konteste gjyqësore për moszbatim të kontratës

Rekomandimi 8 Kryetari i duhet të diskutoj me zyrtarët e prokurimit për dëmet që sjellë anashkalimi i procedurave të duhura të prokurimit, si dhe të marr masat që procedurat e prokurimit kryhen në përputhje të plotë me Ligjin për Prokurim Publik. Fondet për financimin e projeteve duhet siguruar para se procedurat e prokurimit të kenë filluar.

9. Çështja - Sigurimi i ekzekutimit jo sipas rregullave të LPP dhe vonesa në realizimin e projektit - Prioriteti-i rëndësishëm

E gjetura Më 11.04.2012 ishte lidhur kontratë në shumë prej 148,435€ për ndërtimin e rrugës "Rripaj-Jahoc". Në bazë të rishikimit, kemi vërejtur se prokurimi nuk ka respektuar rregullat e prokurimit për sigurimin e ekzekutimit prej 10% nga vlera e kontratës. Në këtë rast është pranuar nga operatori sigurimi i ekzekutimit në shumë prej 1,900€. Sipas kriterit të kërkuar në dosje të tenderit dhe rregullave të prokurimit, kjo shumë do të duhej të ishte 14,843€. Raste të njëjta të sigurimit të ekzekutimit jo sipas rregullave ligjore, kemi gjetur edhe në tri kontrata tjera.

I njëjti projekt ishte parashikuar që të përfundoj për 28 ditë pune, por për shkak të mungesës së fondeve, projekti ishte ekzekutuar deri në lartësinë e pagesave prej 19,000€ (aq sa fillimisht ishin zotuar). Raste të ngjashme janë gjetur në shumicën e projekteve të ekzaminuara.

Rreziku Komuna nuk ka respektuar kriteret e dosjes së tenderit duke pranuar sigurimin e ekzekutimit me të ultë se sa shkalla prej 10% nga vlera e kontratës, gjë që rrit rrezikun që operatori të mos përmbushë kontratën në afatet e përcaktuara. Mungesa e fondeve të zotuara kishte ndikuar në ndërprerjen e punimeve.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të siguroj se menaxheri i prokurimit zhvillon procedurat e prokurimit që ndërlidhen me kërkesat e specifikuara të dosjes së tenderit, me synimin që të ngritet siguria e ekzekutimit të punimeve.

4.5.2 Shpenzimet tjera

Konkluzion i përgjithshëm mbi shpenzimet

Komuna nuk ka kontrolle funksionale në shrytëzimin e parasë publike, përkatësisht paradhënies për udhëtime jashtë vendit.

10. Çështja - Çertifikimi i pagesave pa dokumente të justifikueshme - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Me rastin e rishikimit të pagesës prej 1,450€ kemi gjetur se kjo pagesë ishte bërë në emër të shpenzimeve të udhëtimit për delegacionin nga Kroacia të cilët kanë vizituar komunën e Gjakovës. Ne nuk kemi gjetur se agjenda për këtë vizitë përfshinte edhe pagesën e udhëtimit zyrtar. Pagesa është çertifikuar në bazë të faturës (pa kupon fiskal) që ka lëshuar "Joni Tours".

Rreziku Pagesa në emër të shpenzimeve për udhëtim zyrtar në emër të delegacionit Kroat, duke mos pasur ndonjë vendim paraprak nga Kryetari mund të ketë rrezik se shpenzimi është bërë pa justifikim të duhur.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të siguroj se çertifikimi i çdo pagese do të bëhet në bazë të dëshmive të cilat e vërtetojnë se shpenzimi vërtetë ka ndodhur.

11. Çështja - Thesari ekzekuton pagesa pa raport të pranimit - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Me datën 17.05.2010 ishte lidhur kontratë në mes komunës dhe operatorit "Ifratek" për hartimin e dy projekteve. Pasi ishte kryer hartimi i projekteve, komuna kishte pranuar faturën me datën 22.09.2011 në shumë prej 49,750€. Komuna nuk kishte kryer pagesën dhe si rezultat i kësaj, operatori kishte bërë kërkesë në MF- Drejtorinë e Thesarit për ekzekutim të pagesës. Më 07.12.2012, Njësia për Monitorim kishte obliguar pagesën ndaj furnitorit me ç'rast komuna nuk kishte përfillur rekomandimin për pagesën e obligimit. Me datën 19.12.2012 ishte formuar një komision prej pesë (5) antarëve për verifikim, vlerësim dhe pranim të projekteve. Sipas vlerësimit të këtij komisioni projektet e ofruara nga "Infratek" nuk ishin përgaditur konform kërkesave me norma të ndërtimit. Andaj, ky komision kishte kërkuar që të mos bëhet pagesa pa u bërë përmirësimet në dy projektet nga operatori. Edhe pse operatori nuk kishte bërë përmirësimet e duhura, atij i është paguar fatura në bazë të rekomandimit të Thesarit me datën 26.12.2012.

Rreziku Për pagesën e kryer në emër të furnitorit "Infratek" duke u bazuar në nenin 39.2 të LMFP, Thesari duket se nuk ka respektuar plotësisht kushtet e kontratës. Pagesa ndaj operatorit pa bërë korrigjimet dhe plotësimet në hartimin e dy projekteve mund të ketë si rrezik që këto projekte të paguara të mos mund të implementohen në terren.

Rekomandimi 11 MF - Thesari duhet të marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuese dhe të zbatoj LMFP plotësisht, duke mos ekzekutuar pagesa pa pasur raportin e komisionit për vlerësim dhe pranim të projektit, si dhe përmirësimet e kushteve tjera për pagesë.

4.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: a) bëhet kontrollimi i pagesave çdo muaj duke e nënshkruar listën e pagave b) verifikohen ndryshimet e mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve c) rishikohet buxheti për këtë kategori dhe bëhen barazimet me thesarin.

Për këtë kategori testuam 14 mostra ku rishikuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e payrollit në MAP. Po ashtu, kemi shikuar nëse pozitat e zyrtarëve dhe

koeficientet janë në pajtueshmëri me formën e sistemit të payrollit dhe listës së pagave dhe konstatoam se kërkesat e theksuara më lart janë në pajtim me ligjin. Në bazë të rishikimit ne nuk kemi gjetur ndonjë parregullsi domethënëse.

4.5.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Sipas rishikimit analitik, shpenzimet për subvencione gjatë vitit 2012 kanë qenë 1,069,566€. Për testim kemi marrë gjithsej 13 mostra në vlerë prej 361,676€, apo rreth 34%.

12. Çështja - Furnizim pa procedura të prokurimit - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Gjatë vitit 2012, komuna kishte bërë pagesa në shumë prej 256,526€ në emër të furnizimeve me farë misri, gruri dhe plehra artificial. Kjo shumë ishte paguar në emër të obligimit të papaguar nga viti 2011. Ne kemi gjetur se operatori, përkatësisht furnizuesi ishte përzgjedhur pa aplikuar procedura të prokurimit. Furnizimi me operatorin ishte bërë pa kontratë. Po ashtu, komuna nuk kishte bërë kriteret e qarta që duhej t'i plotësonin përfituesit.

Rreziku Pagesa e faturave për vitin 2011 pa procedura të prokurimit, mund të këtë si pasojë që mjetet të shpenzohen në mënyrë jo racionale. Përzgjedhja e operatorëve pa procedura ka si pasojë eliminimin e konkurrencës dhe dëmtimin e transparencës së procesit. Së këndejmi, furnizimet mund të jenë kryer mbi çmimet e tregut.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të siguroj kriteret e qarta se cilat do të jenë fushat që mund të subvencionohen, cilat shuma mund t'i aprovoj Kryetari e cilat Asambleja komunale, dhe aspektet tjera procedurale (raportimi, mbikëqyrja, etj). Dukuria e furnizimeve në këtë mënyrë duhet të ndërpritet.

13. Çështja - Transferohen mjete për OJQ Radio Gjakova pa paralogari dhe projekt buxhetim - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Me vendim të kryetarit me datë 03.12.2012 lejohen mjete në vlerë prej 31,530€ për OJQ Radio Gjakova, kërkesa e së cilës kërkonte përkrahje financiare për organizimin e shfaqjes së koncertit të Filharmonisë së Vjenës. Organizata nuk kishte paraqitur në kërkesë asnjë paralogari të detajuar, projekt buxhetim apo kontratë me institucionin nga Viena për mysafirët që do të kontribuonin në këtë koncert, siç shpjegohej në projekt propozimin e tyre.

Rreziku Si rezultat i mos paraqitjes së projektit detal nga përfituesi mund të ketë rrezik që paraja publike të mos jetë shpenzuar për qëllimet e dedikuara dhe vendimet e marra aty për aty, nuk sigurojnë se fondet po shfrytëzohen në mënyrën e duhur.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të siguroj se pagesa për subvencione dhe transfere bëhet vetëm në bazë të dëshmive duke marrë parasysh kërkesën dhe projektin detal me qëllim që të zvogëlohet mundësia për manipulim të mundshëm me paranë publike.

14. Çështja - Mungojnë listat me nënshkrime të përfituesve - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Më 06.08.2012 Kryetari kishte miratuar kërkesën e Drejtorisë së Kulturës për të mbështetur financiarisht Klubin Futbollistik Vëllaznimi, në vlerë prej 11,250€ për fillimin e garave sportive në kampionatin e superligës së futbollit. Financimi kërkohej për pagat e lojtarëve, mirëpo nuk ishte paraqitur asnjë listë nënshkrimesh nga ana e lojtarëve dhe shumat përkatëse. Financime të ngjashme janë bërë edhe dy herë me nga 8,600€ në muajin Maj.

Rreziku Komuna e Gjakovës nuk ka politika dhe procedura të qarta për dhënien e subvencioneve. Fakti se listat e pagave nuk janë firmosur nga futbollistët mund të ketë rrezik se këto mjete nuk janë shpenzuar në mënyrë racionale.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të siguroj se rregullorja do të aprovohet së shpejti në Kuvendin Komunal dhe ajo do të jetë aplikative me rastin e shpenzimeve nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve.

4.6 Pasuritë

Konkluzioni i përgjithshëm mbi pasuritë

Komuna ka bërë progres të dukshëm në regjistrimin e pasurive, krahasuar me vitin paraprak, por ajo që mbetet ta bëjë menaxhmenti, është vlerësimi i plotë i pasurive në pronësi të komunës, duke pasur parasysh se disa prej lokaleve që janë në shfrytëzim prone të komunës nuk janë regjistruar.

4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Komuna ka vazhduar me procesin e regjistrimit të pasurive edhe në vitin 2012, dhe në këtë aspekt vërehet një progres i mirë. Në vitin 2011 sipas PVF pasuritë jo-financiare mbi 1,000€ ishin regjistruar në shumë prej 29,676,000€, ndërsa në vitin 2012 vlera e pasurive të regjistruara kishte arritur në 34,896,000€..

15. Çështja - Mungesa e regjistrimit të plotë të pronës- Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Me rastin e rishikimit të pasurive jo financiare kemi vërejtur se në regjistrin e zyrtarit të pasurisë ishin regjistruar pasuritë kapitale dhe ato jo kapitale. Mirëpo, këto evidenca nuk ishin plotësuar me pasuritë e paregjistruara, ngase komisioni i cili ishte formuar vite me parë, nuk kishte arritur të bëjë vlerësimin e plotë të pasurisë.

Rreziku Mos regjistrimi i plotë i të gjitha pronave përkatësisht objekteve afariste të cilat janë në pronësi të komunës, kanë rezultuar në shfrytëzimin e tyre nga individë të ndryshëm për aktivitete biznesi, duke mos i paguar komunës kurrëfarë taksash..

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të siguroj që në një kohë sa më të shkurtër të riaktivizoj komisionin dhe të vazhdoj me procesin e mbetur të regjistrimit. Gjithashtu, një komision inventarizimi duhet të themlehet çdo vit për të bërë barazimet e gjendjes kontabël me gjendjen faktike të pasurive.

4.6.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Komuna ka raportuar të arkëtueshmet në pesë (5) grupe kryesore : tatimi në pronë në shumë prej 3,426,000€, taksë për ushtrimin e veprimtarisë në shumë prej 967,000€, qiratë e lokaleve në shumë prej 351,000€, qiratë e tokave në shumë prej 154,000€ dhe qiratë e parkingjeve në shumë prej 11,000€. Pra, shuma totale e llogarive të arkëtueshme deri në dhjetor të vitit 2012 ishte 4,908,000€.

16. Çështja - Menaxhim i dobët i llogarive të arkëtueshme - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Ne kemi vërejtur se të komuna ka probleme më të arkëtueshmet nga tatimi në pronë, taksa në firmë, taksa mbi qiradhëniet dhe taksa mbi shfrytëzimin e pronës publike. Sipas raporteve financiare të komunës në fund të vitit 2012, shuma e pa inkasuar nga këto pesë lloje llogarish arrinë shifrën rreth 4.9 milion euro.

Rreziku Gjendja e llogarive të pa mbledhura po rritet nga viti në vit dhe paraqet një shumë domethënëse për buxhetin e komunës. Nuk duket se menaxhmenti ka strategjinë e duhur se si t'i çaset këtij problemi. Kjo ka ndikime buxhetore në planifikimin e financimit të projekteve nga burimet vetjake.

Rekomandimi 16 Kryetari duhet të përgatis një Plan veprimi ku do të propozohen udhëzime të qarta për të gjithë sektorët relevant të komunës për ngritjen e inkasimeve të të gjitha borxheve. Plani duhet të përmbaj prioritete, ndarjen e borxheve sipas vjetërsisë, afatet kohore për veprimet që duhet të merren, arsyet e mospagesës, mekanizmat e duhur dhe diskutimin e arritjeve, së paku dy herë në vit.

4.7 Trajtimi i borxheve

Konkluzioni i përgjithshëm mbi trajtimin e borxheve

Buxheti i këtij viti në masë të konsiderueshme ishte shpenzuar për pagesën e obligimeve të mbetura gjatë katër (4) viteve të fundit, dhe për pasojë, një pjesë e projekteve kapitale të parashikuara për vitin 2012 nuk ishin realizuar për shkak të fondeve të kufizuara.

Si shkak i mos planifikimit të mirë gjatë vitit 2012, ishin paguar për shpenzime kapitale, mallra dhe shërbime si dhe subvencione për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011 shuma prej 1,805,162€.

Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2012 ishte 711,000€ si dhe detyrime kontigjente në shumë prej 228,000€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2013.

17. Çështja - Hyrje në obligime përtej buxhetit të aprovuar - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Sipas ekzaminimeve tona kemi vërejtur se komuna ka hyrë në obligime më shumë se ndarjet buxhetore. Fondi i ndarë për mallra dhe shërbime ishte 1,735,414€, ndërsa ishin shpenzuar 1,708,009 apo 98%, ndërsa obligimet e pa paguara për këtë kategori ishin 223,000€. Gjithashtu edhe shpenzimet komunale ishin shpenzuar 649,066€ apo 100%, derisa obligimi i papaguar për këtë kategori në fund të vitit 2012 ishte 104,000€ si dhe fondi për subvencione ishte shpenzuar 1,069,566€ apo 100% deri sa obligimet e mbetura në fund të vitit ishin 2,000€ si dhe obligime nga investimet kapitale ishin 382,000€. Shuma totale e obligimeve duke përfshirë edhe ato kontigjente deri më 31 dhjetor 2012 ishin 939,000€

Rreziku Dobësitë në hartimin e buxheteve të nevojshme kanë shkaktuar krijimin e detyrimeve përtej parametrave të lejuar buxhetor. Hyrja në detyrime pa fonde të sigurta mund ta sjellë komunën në vështirësi të papritura financiare dhe përballjen me konteste gjyqësore.

Rekomandimi 17 Kryetari duhet të siguroj hartimin e një buxheti real dhe të qëndrueshëm. Kontrollat buxhetore duhet të forcohen nga mbajtësit e buxheteve, për të siguruar balancin midis obligimeve dhe fondeve në dispozicion.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Konkluzion i përgjithshëm mbi sistemin e auditimit të brendshëm

Në Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2012, auditori i brendshëm kishte planifikuar t'i kryej pesë (5) raporte, dhe kishte arritur të përmbushë në tërësi planin e tij vjetor.

Ne kemi rishikuar raportet e auditorit të brendshëm dhe kemi vlerësuar se edhe përkundër identifikimit të disa çështjeve shumë të rëndësishme, nuk mund të thuhet se ka përmbushë misionin e tij. Kjo njësi duhet të ketë në fokus trajtimin e fushave me rrezik të lartë, siç është prokurimi, detyrimet e pa paguara, borxhet e pa mbledhura, etj.

Gjatë periudhës raportuese të auditimit tonë, kemi vërejtur se komiteti i auditimit nuk kishte qenë aktiv në punën e tij. Prandaj, me vendim të kuvendit komunal më dt. 24.11.2011, komiteti i auditimit kishte pushuar së ekzistuari.

Përshkrimi

Auditori i brendshëm kishte kryer këto auditime: (a) mallra dhe shërbime, dhe (b) subvencione dhe transfere për vitin 2011, (c) hyrat nga tatimi në pronë, leje ndërtimi për periudhën janar - shkurt të vitit 2012, (d) auditimin e shpenzimeve komunale në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport për periudhën janar- prill 2012, si dhe (e) auditimin e menaxhimit të pasurive për periudhën janar - shtator 2012.

18. Çështja - Auditim i pjesshëm nga NJAB - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura NJAB vetëm pjesërisht kishte kryer vlerësimin mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme gjatë vitit 2012. Dobësitë e paidentifikuara dhe të pa adresuara mund të rezultojnë në humbje financiare për komunën. Për më tepër, vërehet një adresim i dobët i rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

Rreziku Mos përfshirja në plan të auditimit e fushave me rrezik të lartë, ndjekja e aktiviteteve nga vitet e kaluara dhe adresimi i dobët i rekomandimeve, janë dobësitë kryesore në auditimin e brendshëm. Të gjitha këto mund të rezultojnë në kontrolle të brendshme të pamjaftueshme dhe dobësi të vazhdueshme në fushat e ndryshme

Rekomandimi 18 Kryetari duhet të siguroj se në planin vjetor të NJAB përfshihet auditimi i fushave me rrezik të lartë, si: auditimi i të hyrave, shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve dhe pasurisë, duke patur si fushëveprim parësor aktivitetet e vitit aktual. Gjithashtu, duhet të hartohet një Plan veprimi për adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të NJAB.

6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni ynë i përgjithshëm pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve që lidhen me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit si dhe Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Niveli i pajtueshmërisë me kornizën raportuese mund të përmirësohet. Derisa disa përmirësime janë zbatuar që nga viti 2011, PVF-të për 2012 nuk kanë adresuar plotësisht rekomandimet tona ose komentet e bëra për llogaritë 9 mujore.

Ne kemi vërejtur se vetëm tri rekomandime të bëra në vitin 2012 ishin zbatuar plotësisht dhe tri të tjera pjesërisht, kurse katër prej tyre nuk ishin adresuar fare. Mungesa e një Plani të Veprimit ka bërë që të mos bëhet implementimi i të gjitha rekomandimeve nga viti 2011 dhe një pjesë e rekomandimeve të përsëriten në këtë vit.

Komuna ka realizuar 19,624,022 € nga buxheti i përgjithshëm prej 20,123,480€, ose 98% e totalit. Në kuptimin sasior, kjo është një përqindje maksimale, por në kuptimin cilësor janë identifikuar dobësi të shumta. Mbi 1.8 milionë ishin paguar detyrime nga vitet e kaluara, ndërsa në PVF-të e vitit 2011 ishin raportuar vetëm 587 mijë. Kjo i bie se mbi 1.2 milionë detyrime të pa paguara nuk ishin raportuar fare dhe janë paguar jashtë planifikimeve të rregullta buxhetore. Edhe Thesari kishte bërë në emër të komunës një

pagesë të mbetur nga viti 2011 në shumë rreth 50 mijë euro. Menaxhimi i detyrimeve vazhdon të mbetet pika më e dobët e menaxhmentit. Edhe në fund të vitit 2012 janë raportuar gati 940 mijë euro detyrime të pa paguara, prej të cilave 220 mijë euro janë detyrime kontingjente.

Komuna vazhdon të hyj në detyrime kontraktuale, pavarësisht fondeve buxhetore në dispozicion. Tri kontrata janë lidhur në shumën 550 mijë euro, ndërsa shumat e zotuarra për këto kontrata ishin vetëm 66 mijë euro. Si rezultat i mungesës së fondeve, punimet në këto projekte janë vonuar apo janë ndërprerë fare. Në mungesë të zotimeve, edhe sigurimi i shumave për ekzekutimin e punimeve ishte bërë ekuivalent me shumat e zotuarra dhe jo në shumat e kontraktuarra.

Një pagesë signifikante prej 256 mijë euro nga viti 2011 ishte bërë në emër të subvencioneve një furnizuesi me artikuj bujqësor (farë, plehra artificial). Lidhur me këtë kontratë, nuk ishin zhvilluar kurrëfarë procedurash të prokurimit. Parregullsi tek subvencionet janë vërejtur edhe në rastet tjera, dhe masat e përmirësimit në këtë fushë janë më se të nevojshme.

Nuk ka ndonjë menaxhim të mirë as me borxhet e pa inkasuara. Gati 5 milionë euro janë llogaritë e akumuluarra të borxheve nga vitet e kaluara, dhe menaxhmenti nuk ka strategji të qartë se si t'i çaset këtij problemi. Ka shumë shfrytëzues që nuk paguajnë kurrëfarë taksash për shfrytëzimin e hapësirave publike. Madje, komuna as që posedon një regjistër përfundimtar për të hyrat nga qiraja dhe obliguesit qiramarrës.

Fusha ku kemi vërejtur përmirësime ka të bëjë me vazhdimin e procesit të regjistrimit të pasurive, ndonëse ky proces është mjaft kompleks dhe merr kohë për t'u përfunduar. Ne inkurajojmë menaxhmentin e komunës në vazhdimin e këtij procesi.

Konkluzioni ynë përfundimtar është se komuna ka nevojë për një rishikim thelbësor të sistemeve, në veçanti në përmirësimin e planifikimit buxhetor, përkatësisht në inkorporimin e detyrimeve të mbetura dhe raportimin e tyre të drejtë, në ndërprerjen e praktikave të hyrjes në kontrata pa zotimet paraprake dhe në hartimin e një strategjie me mekanizmat adekuat për ngritjen e inkasimeve.

Funksioni i auditimit të brendshëm duhet të fuqizohet, kur kihet parasysh se kontrollet në nivel operativ nuk funksionojnë mjaftueshëm në parandalimin e parregullsive.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinion i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinion i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
5 Pasqyrat vjetore financiare	Se me rastin e hartimit të PVF, të gjitha informatat e kërkuara do të plotësohen dhe shpalosen drejt dhe në pajtim me kornizën raportuese.	PO		
6.1 Të hyrat vetjake	<p>Analizoj në mënyrë gjithëpërfshirëse shkallën e ultë të inkasimeve dhe borxhet e mbetura dhe të ndërmerr veprimet adekuate që kjo dukshëm të përmirësohet. Një ngritje e përgjegjësive duhet të instalohet në të gjitha nivelet e menaxhimit;</p> <p>Sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë shënime të sakta për të gjithë qiramarrësit, shfrytëzuesit e pronës publike dhe lejeve të ndërtimit; dhe</p> <p>Forcohen masat inspektuese për identifikimin e ndërtimeve dhe të kërkojë nga qytetarët për t'u pajisur me leje ndërtimi dhe të paguajnë taksat përkatëse.</p>		Pjesërisht është realizuar ky rekomandim.	
6.2.1 Prokurimi	Që projektet të fillojnë dhe të përfundojnë në bazë të planit dinamik të ofruar nga punë kryesi dhe për mos zbatim të planit aplikohen penalet;			Nuk është implementuar

	<p>Se furnizimet me material zyre pranohen dhe vendosen në depo duke regjistruar hyrjen dhe daljen e tij;</p> <p>Se për të gjitha projektet e filluara, fondet e financimit janë të sigurta; dhe</p> <p>Se me rastin e pranimit të derivateve të naftës për ngrohje, bëhet verifikimi i sasive të furnizuara dhe pagesave.</p>			
6.2.3 Subvencionet dhe transferet	<p>Asnjë shpenzim nuk do të lejohet jashtë procedurave të duhura të prokurimit;</p> <p>Pagesa dhe dhënia e subvencioneve bëhet vetëm pas Vendimit të Kryetarit të Komunës; dhe</p> <p>Asnjë pagesë nuk do të lejohet pa pasur bazën e duhur ligjore.</p>	Po		
6.3.1 Trajtimi i të arkëtueshmeve	<p>Që programi të cilin e aplikon zyra e financave mund të prodhojë në çdo kohë informata të sakta dhe të plota për të gjitha llogaritë e arkëtueshme, duke prezantuar edhe gjendjen e tyre historike.</p>			Nuk ishte implementuar.
6.3.2 Trajtimi i pasurive kapitale dhe jo-kapitale	<p>Se do të formohen komisione të veçanta për regjistrim, vlerësim dhe inventarizim të pasurisë, se do të bëhen krahasimet e rezultateve të regjistrimit me gjendjen kontabël dhe do të nxirret një regjistër përfundimtar i pasurive. Gjithashtu, në shpalosje të PVF duhet të prezantohet edhe vlera vjetore dhe e akumuluar e zhvlerësimit të pasurive.</p>		Pjesërisht është realizuar ky rekomandim.	

6.4 Trajtimi i borxheve	Se departamenti i financave mban evidenca të plota dhe të sakta dhe bënë regjistrimin e të gjitha faturave të paguara dhe të papaguara, në mënyrë që të shmanget mundësia e pagesës së tyre më tepër se një herë.	Po		
7.1 Sistemet e kontrollit të brendshëm	Rishikimin e sistemit aktual të kontrollit të brendshëm dhe për fushat e identifikuar si dështime të kontrolleve, të nxirren politika dhe procedura specifike me qëllime përmirsimi.		Pjesërisht është realizuar ky rekomandim.	.
7.2 Sistemi i auditimit të brendshëm	Se NJAB në veçanti do të trajtoj aktivitetet operative të komunës për vitin aktual, duke identifikuar fushat me rrezik të lartë; dhe Se komiteti i auditimit do të jetë me funksional në adresimin e çështjeve të auditimit dhe përmbushjen e detyrave			Jo nuk ishte implementuar.
8 Një konkluzion i përgjithshëm mbi menaxhmentin e Gjakovës	Do të diskutoj me Bordin e Drejtorëve të gjitha dobësitë dhe mangësitë e menaxhimit financiar të identifikuar me këtë raport, si dhe nevojën e forcimit të kontrolleve, dhe të propozoj masat adekuate të veprimit.		Pjesërisht është implementuar ky rekomandim.	